



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Metodika e Statistikave Monetare dhe Financiare

DEPARTAMENTI I STATISTIKËS

2020

PUBLIKUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Garibaldi 33, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

Ueb-faqe: www.bqk-kos.org

E-mail: statistics@bqk-kos.org

Përmbajtja

1.	Hyrje	6
2.	Struktura e sektoriale e institucioneve monetare dhe financiare	6
3.	Baza ligjore.....	7
4.	Organizimi i Brendshëm	7
5.	Metodologjia e përdorur	9
6.	Grumbullimi dhe shpërndarja e të dhënave	9
6.1.	Institucionet raportuese	9
6.2.	Grumbullimi i të dhënave:	9
6.3.	Afati Kohor.....	10
6.4.	Kontrollimi i të Dhënave	10
6.5.	Rishikimi i të dhënave	10
6.6.	Përpilimi dhe shpërndarja e statistikave monetare	11
6.6.1.	Përpilimi i të dhënave	11
6.6.2.	Shpërndarja e të dhënave	11
6.7.	Shfrytëzimi i statistikave nga palët tjera	12
7.	Rregullat dhe parimet për përpilimin e bilanceve dhe pasqyrave të bilcore	12
8.	Sektorët institucional	13
9.	Instrumentet Financiare.....	15
10.	Struktura e pasqyrave bilcore	18
10.1.	Pasqyra e BQK.....	18
10.2.	Pasqyra e Korporatave tjera Depozituese	19
10.3.	Pasqyra e Korporatave Depozituese	19
10.4.	Pasqyra e Korporatave Tjera Financiare	19
10.5.	Pasqyra e Korporatave Financiare.....	19
11.	Normat e interesit.....	22
12.	Fjalori.....	23

1. Hyrje

1. Ky dokument ka për qëllim të ju ofrojë përdoruesve një përmbledhje të veçorive kryesore metodologjike për statistikën monetare dhe financiare. Konceptet dhe përkufizimet janë në përputhje me manualin ndërkombëtar.
2. Dokumenti përmban shpjegime të përgjithshme për çdo komponent të bilanceve dhe pasqyrave të bilanceve që publikohen nga statistikën monetare dhe financiare në Republikën e Kosovës.
3. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) përpilon dhe publikon të dhënat statistikore monetare dhe financiare si dhe statistika të normës së interesit. Brenda statistikave monetare, të dhënat përpilohen dhe publikohen në baza mujore, tremujore dhe vjetore.
4. Përveç bilanceve dhe pasqyrave të bilanceve të korporatave tjera depozituese, në baza mujore raportohen edhe bilancet dhe pasqyrat e institucioneve të tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, kompanitë që ofrojnë lizing financiar, institucionet mikrofinanciare, institucionet për transfer të parave. Pasqyrat e fondeve të pensioneve deri 2020 janë publikuar në baza tremujore, tani e tutje raportohen në baza mujore.

Të dhënat janë paraqitur në monedhën euro.

Ky dokument lëshohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Statistikës në BQK dhe publikohet në ueb-faqen e BQK-së (www.bqk-kos.org).

2. Struktura e sektoriale e institucioneve monetare dhe financiare

(asetet në miliona euro)

Sektorët financiar	Numri	Asetet	Vendore		Të jashtme		Degët dhe nëndegët
			Numri	Asetet	Numri	Asetet	
Banka Qendrore	1	1,543.5	1	1,479.1	-	-	1
Korporatat tjera depozituese	11	4,760.5	2	616.107	9	4,144.40	216
Kompanitë e sigurimit	13	196.3	7	97.51	6	98.79	490
Ndërmjetësit tjerë financiar	21	308.4	8	19.25	13	289.19	148
Fondet pensionale	2	1,976.4	1	1,968.16	1	8.27	4
Ndihmësit financiar	50	16.7	50	16.7	-	-	-

3. Baza ligjore

5. Për përmbushjen e objektivave të veta, BQK-ja përpilon dhe publikon statistikat monetare dhe financiare bazuar në ligjin mbi statistikat të BQK-së neni 25 i Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 25, BQK-ja ka këto përgjegjësi për të përmbushur objektivat e saj:
 - mbledhë, përpilojë, analizojë, përmbledhë dhe publikojë statistika dhe informacione të nevojshme për realizimin e detyrave të veta;
 - Bordi i Bankës Qendrore do të përkufizojë, me anë të rregulloreve, informacionin statistikor të kërkuar si dhe formën në të cilën ky informacion do t'i sigurohet Bankës Qendrore, personave fizikë dhe juridikë që iu nënshtrohen kërkesave të raportimit, regjimin e aplikuar të konfidencialitetit si dhe ndëshkimet administrative, në përputhje me nenin 67, paragrafi 2 të këtij ligji, që mund t'u shqiptohen personave fizikë dhe juridikë që veprojnë në shkelje të këtyre kërkesave statistikore;
 - bashkëpunojë me ministritë dhe agjencitë qeveritare në mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave dhe informacioneve të tjera relevante;
 - koordinojë me agjenci bilaterale dhe multilaterale adaptimin e standardeve ndërkombëtare të shpërndarjes së të dhënave me qëllim të arritjes së konsistencës dhe efikasitetit në organizimin e statistikave dhe informacionit.
6. Për më tepër, sipas "Ligjit për Statistika Zyrtare të Republikës së Kosovës", BQK-ja është një nga prodhuesit kryesorë të statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës. Statistikat nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të BQK-së janë statistikat monetare dhe financiare dhe statistikat e sektorit të jashtëm.

4. Organizimi i Brendshëm

7. BQK-ja menaxhohet nga Bordi i Bankës Qendrore, i cili përbëhet nga Guvernatori dhe katër anëtarë jo ekzekutiv, të cilët janë përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe mbikëqyrjen e administratës dhe aktiviteteve të BQK-së.
8. BQK-ja është e ndarë në departamente dhe divizione. Divizioni i Statistikave Monetare dhe Financiare operon në Departamentin e Statistikave dhe aktualisht përbëhet nga 3 punonjës, të cilët janë përgjegjës për përpilimin, metodologjinë dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe financiare në Kosovë.

5. Metodologjia e përdorur

9. Përpilimi dhe paraqitja e statistikave monetare dhe financiare bazohen në rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare, në veçanti:
 - > Manuali i Statistikave Monetare dhe Financiare, FMN, 2000;
 - > Udhëzues për përpilimin e statistikave monetare dhe financiare, FMN, 2016;
 - > Sistemi i Llogarive Kombëtare - SNA 2008, KB.
 - > Manuali mbi Statistikat e Normave të Kamatës (BOE, 2001/18)
 - > Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Regjionale (ESA 95)

6. Grumbullimi dhe shpërndarja e të dhënave

6.1. Institucionet raportuese

10. Për qëllime të përpilimit të statistikave monetare, të gjitha korporatat financiare të licencuara nga BQK konsiderohen njësi raportuese.

Institucionet raportuese janë si në vijim:

- Korporatat tjera depozituese (bankat komerciale),
- Institucionet mikrofinanciare,
- Fondet e pensioneve,
- Kompanitë e sigurimeve,
- Kompanitë e lizingut financiar,
- Këmbimoret,
- Institucionet për transfer të parave

6.2. Grumbullimi i të dhënave:

11. Brenda afatit të paraparë kohor obligohen që secili institucion financiar raportues të bëjnë ngarkimin e raportit mujorë në sistem e BQK-së. Institucionet raportuese kanë kodin e identifikimit, kodin për qëllime të raportimit dhe periudhën kohore. Bazuar në këto informata departamenti i statistikës bënë mbledhjen e të gjitha statistikave veq e veq ose në mënyrë të agreguar (varësisht nga nevojat e departamentit) duke shfrytëzuar përparësit që ofron sistemi.
12. Grumbullimi i statistikave bëhet përmes raporteve si në vijim:
 - *Raporti statistikor i bankave* – përfshin këto lloje të informatave: bilanci i gjendjes, bilanci i gjendjes sipas shteteve, bilanci i suksesit, kreditë sipas sektorëve ekonomik, kreditë sipas maturitetit në euro dhe jo euro, depozitat sipas maturitetit në euro dhe jo euro, letrat me vlerë (banka si emetues), letrat me vlerë si borxhë.
 - *Raporti i normave të interesit të bankave* – përfshin këto lloje të informatave: norma e interesit në kredi dhe norma e interesit në depozita,
 - *Raporti i normave të interesit të institucioneve mikrofinanciare* - përfshinë normen e interesit në kredi,
 - *Raporti i kredive dhe depozitave të reja i bankave* – përfshin këto lloje të informatave: kreditë dhe depozitat e reja të realizuara brenda muajit raportues,
 - *Raporti i kredive të reja i institucioneve mikrofinanciare*, përfshinë kreditë e reja të realizuara brenda muajit raportues.
 - *Raporti statistikor i institucioneve mikrofinanciare (RSIM)* – përfshin gjashtë lloje të informatave: Bilancin e gjendjes, pasqyra e te ardhurave, kreditë sipas aktivitetit ekonomik, kreditë sipas maturitetit, lizingun financiar, depositat sipas maturitetit,
 - *Raporti i kompanive të sigurimit*, përfshin: aktivitetin e kompanive të sigurimit, bilancin e gjendjes dhe pasqyrën financiare
 - *Raporti i ndihmësve financiar*, përfshin: bilanci i gjendjes, pasqyra financiare dhe transferat ndërkombëtare,
 - *Raportet e fondeve pensionale* përfshin bilancin e gjendjes.

6.3. Afati Kohor

13. Përgatitja e statistikave monetare dhe financiare rezulton nga disa faza: grumbullimi, validimi, , përpilimi dhe publikimi. Tabela në vijim tregon afatet kohore për secilën fazë:

Përshkrimi	Grumbullimi	Validimi	Përpilimi	Publikimi
Banka Qendrore	t+10	t+12	t+12	t+15
Bankat Komerçiale				
Raporti Statistikor i Bankave	t+15	t+18	t+21	t+23
Norma e interesit	t+15	t+18	t+21	t+23
Kredit dhe Depozitat e reja	t+15	t+18	t+21	t+23
Institucionet Mikrofinanciare	t+15	t+20	t+22	t+25
Kreditë e reja	t+15	t+18	t+21	t+23
Norma e interesit	t+15	t+18	t+21	t+23
Raporti Statistikor i Institucioneve Mikrofinanciare	t+15	t+20	t+22	t+25
Kompanitë e Sigurimit - Mujore	t+15	t+20	t+22	t+25
Fondet Pensionale	t+15	t+20	t+22	t+25

6.4. Kontrollimi i të Dhënave

14. Në sistemin softverik të mbledhjes së statistikave monetare janë vendosur rreth 1500 rregulla të validimit. Përmes këtyre rregullave kontrollohet ç'do karakter i vendosur në raportet e institucioneve financiare. Kështu në menyre automatike do të parandalohet ngarkimi i të dhënave me gabime.
15. Kontrollimi bëhet për qëllime të validimit, si edhe në nivel teknik, për të verifikuar përmbajtjen e tyre (përshtatshmërinë, plotësinë, etj.) dhe kohezionin. Procedurat e kontrollit kanë për qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave. Kontrollat sistematike të cilësisë përfshijnë: largimin e gabimeve në përpunimin e të dhënave, mos-përpunueshmëritë, etj.
16. Verifikimi i cilësisë së të dhënave në nivelin më të ulët fillon me verifikimet për çdo raport individual (Raporti Statistikor i Bankave (RSB), Raporti Statistikor i Institucioneve MikroFinanciare (RSIMF), Raporti Statistikor i Kompanive të Sigurimeve (RSKS)), si dhe verifikimi nëse të dhënat nga raportet e cekura përpunohen me njëra tjetrën. Çdo mospërpunueshmëri e konsiderueshme hetohet drejtpërdrejtë me institucionet raportuese. Përveç kësaj, hetohen edhe mospërpunueshmëritë statistikore dhe treguesit tjerë potencial të problemeve në Oputputet statistikore.

6.5. Rishikimi i të dhënave

17. BQK është e angazhuar të përmirësojë dhe rrisë cilësinë e statistikave të prodhuara, duke ndjekur dhe zbatuar standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Te korporatat financiare të dhënat e dhjetorit rishikohen rregullisht në baza vjetore brenda një periudhe prej t + 90 ditësh pas përfundimit të muajit, bazuar në të dhënat që bankat dhe institucionet tjera financiare paraqesin brenda afatit të përcaktuar për auditim vjetor të pasqyrat financiare.

Gjithashtu, nëse është e nevojshme, të dhënat e publikuara mund të rishikohen më shpesh në rastet e:

- marrjes së informacionit dhe të dhënave të reja dhe / ose të korrigjuara nga njësitë raportuese; ose
- ndryshime në burimet e të dhënave ose metodologjinë për përpilimin e një informate të veçantë statistikor.

18. Në përputhje me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare, statistikave rishikuar hijezohen dhe jepet një shpjegim adekuat për ndryshimet e rëndësishme në të dhënat e bëra gjatë rishikimeve, në një fusnotë ose në njoftimet për shtyp.
19. Të dhënat historike të serive kohore rishikohen nga momenti i shfaqjes së ngjarjes që çojnë në ndryshimin e të dhënave, ndryshimet bëhen për aq kohë sa të jetë e mundur. Nëse ka një ndryshim në paraqitjen e të dhënave (publikimi i një treguesi të ri - sektori, instrumenti etj.), të dhënat historike ndryshohet duke filluar nga momenti i futjes së treguesit të ri, nëse ekzistojnë kushtet e duhura.

6.6. Përpilimi dhe shpërndarja e statistikave monetare

6.6.1. Përpilimi i të dhënave

20. Përpilimi bilancor i statistikave monetare dhe financiare kalon nëpër dy faza. Faza direkte e prodhimit të statistikave përkatësisht bilancet e gjendjes dhe pasqyrat bilancore:
21. Faza e parë përfshin përpilimin e statistikave mbi asetet dhe detyrimet të institucioneve financiare në një raport të vetëm – Bilanci i gjendjes. Më tutje këto raporte përmbajnë të dhëna të hollësishme mbi kredit, depozitat, letrat me vlerë të institucioneve financiare si: Banka Qendrore, Korporatat Tjera Depozituese, fondet e pensioneve, kompanitë e sigurimeve, kompanitë që ofrojnë lizing financiar, këmbimoret.
22. Faza e dytë përfshin konsolidimin e të dhënave nga raportet e Balanceve të gjendjes në Pasqyrat e bilanceve. Qëllimi i përpilimit të këtyre Pasqyrave është pasqyrimi i thjeshtuar i aseteve dhe detyrimeve të korporatave financiare, në një mënyrë që është e përshtatshme për kryerjen e analizave monetare.
23. Pasqyrat analitike rrjedhin nga bilancet përkatëse sektoriale, ku të dhënat e bilancit sektorial janë riorganizuar në një format analitik. Në pasqyrat analitike, asetet paraqiten si pretendime të KF-ve ndaj sektorëve të tjerë institucionalë rezidentë dhe jo rezidentë, ndërsa detyrimet paraqiten sipas kategorisë së instrumentit financiar. Kërkesat dhe detyrimet ndaj jorezidentëve dhe qeverisë qendrore paraqiten në baza neto.
24. Si rezultat i këtij procesi, përpilohen dhe publikohen pasqyrat e mëposhtme dhe raportet:
 - Pasqyra e BQK-së mujore;
 - Pasqyra e Korporatave të Tjera Depozituese;
 - Pasqyra e Korporatave Depozituese;
 - Pasqyra e Korporatave të Tjera Financiare;
 - Pasqyra e Korporatave Financiare;

6.6.2. Shpërndarja e të dhënave

25. Statistikat monetare dhe financiare janë një pjesë e shquar dhe disi e veçantë e sistemit statistikor makroekonomik të Kosovës. Krahasuar me statistikave tjera, përpilimi dhe shpërndarja e SMF-të bëhet në një bazë më të shpeshtë dhe më të duhur.
26. Statistikat monetare dhe financiare publikohen në seri kohore në faqen e internetit të BQK-së në baza të rregullta mujore dhe tremujore, në përputhje me afatin e caktuar të dhënë në kalendarin e publikimeve. Gjithashtu, statistikave monetare dhe financiare janë në dispozicion të përdoruesve edhe në publikimin e buletinit mujor statistikor, i cili gjithashtu mund të gjendet në faqen e internetit të BQK-së.

27. Statistikat e korporatave depozituese (BQK dhe KTD) kanë filluar të publikojnë dhe të prodhojnë të dhëna statistikore prej vitit 2001 në baza të rregullta mujore. Ndërsa statistikat e korporatave tjera financiare kanë filluar të prodhohen dhe të publikohen nga viti 2004 në baza tremujore. Nga viti 2012 të gjitha statistikat përpos fondeve pensionale kanë filluar të prodhohen dhe publikohen në baza të rregullta mujore.
28. Tani të gjitha statistikat monetare dhe financiare publikohen në baza të rregullta mujore. Gjithashtu të dhënat dërgohen në FMN dhe BQE në baza të rregullta mujore sipas formateve të kërkuara, si dhe në Eurostat në baza gjashtëmujore.

6.7. Shfrytëzimi i statistikave nga palët tjera

29. BQK – respektivisht departamenti i statistikës jep informata të detajuara mbi statistikat monetare (të publikuara mbi 40 tabela).

Të dhënat e sektorit monetar janë postuar në ueb-faqen e BQK-së <https://bqk-kos.org/?id=55> , në dispozicion për të gjithë përdoruesit.

Për më tepër, të dhënat dhe publikimet procedohen në parlament, Qeveri, Agjencinë e Statistikave të Kosovës (me qëllim të përpilimit të BPV-së), institucionet private dhe publike kërkimore, universitetet, agjencitë vlerësuese, etj.

Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike është një përdorues i rëndësishëm i të dhënave tona brenda BQK-së.

Këto statistika raportohen në Eurostat, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Qendrore Evropiane në baza të rregullta.

7. Rregullat dhe parimet për përpilimin e bilanceve dhe pasqyrave bilncore

30. Përpilimi i bilanceve të gjendjes dhe pasqyrave mbështetet në këto parime kryesore:

- BQK nuk emeton valutë vendore. Valutë ligjore për pagesa dhe pranime në Kosovë është Euro, prandaj euro do të përdoret si valutë vendore ndërsa të gjitha valutat tjera të konsiderohen si të huaja. Sipas këtij kriteri përmbledhja në regjistrimet e statistikave monetare dhe financiare është si në vijim:

_Të gjitha kërkesat dhe detyrimet ndaj jorezidentëve ose asetet dhe detyrimet e huaja në valuta të tjera përpos Euros regjistrohen si valutë e huaj,

_Të gjitha kërkesat dhe detyrimet ndaj sektorëve të brendshëm ose asetet dhe detyrimet e huaja në Euro regjistrohen si valutë vendore,

_Të gjitha kërkesat dhe detyrimet ndaj sektorëve të brendshëm ose asetet dhe detyrimet e huaja në monedha të tjera përpos Euros regjistrohen si valutë e huaj

- Parimi tjetër i vlerësimit të asetëve dhe detyrimeve financiare në bilance të institucioneve financiare është përdorimi i çmimeve të tregut ose përafërimi me çmimet e tregut.
- Asetet dhe detyrimet në formën e monedhave, depozitave dhe kredive dhe detyrimet në formën e aksioneve dhe formave të tjera të kapitalit vlerësohen me vlerën e librit. Kreditë vlerësohen me vlerën e librit të kërkesave të kreditorit. Për provizionet e kredisë dhe zhvlerësimet e tjera të asetëve fikse njihen në vlerën e tyre kontabël, duke përjashtuar amortizimin e akumuluar i cili është përfshirë në kategorinë e llogarive të tjera të pagueshme.
- Rezidenca - Dallimi ndërmjet entiteteve rezidente dhe jorezidente është i rëndësishëm në statistikat

monetare dhe financiare. Kriteret kryesore për përcaktimin e vendbanimit të njësisë institucionale janë territori ekonomik dhe qendra me interes ekonomik mbizotërues. Territori ekonomik i një vendi përbëhet nga një territor gjeografik i administruar nga qeveria brenda së cilës personat, mallrat dhe kapitali lëvizin lirshëm dhe përfshijnë ajrin, ujin, tokën, zyrat diplomatike jashtë vendit.

• Parimi bazë i përdorur në statistikat monetare, parasheh grumbullimin dhe paraqitjen e të dhënave në bazë kumulative në fundin e periudhës. Përrjashtime bëhen për statistikat specifike si statistikat për kreditë dhe depozitat e reja. Këtu statistikat paraqiten në baza jo kumulative (të dhëna që ndodhin brenda muajit).

8. Sektorët institucional

31. Ndarja e sektorëve dhe nënsektorëve institucionalë përbëhet dy grupe:

- Korporatat financiare dhe
- Korporatat jo financiare

32. *Spektori i korporatave financiare* përbëhet nga të gjitha korporatat ose kuazi-korporatave të angazhuara në ndërmjetësim financiar ose aktivitete mbështetëse financiare që janë të lidhura ngushtë me ndërmjetësimin financiar. Korporatat financiare ndahen në korporata depozituese (banka qendrore dhe korporata të tjera depozituese) dhe korporata të tjera financiare (ndërmjetës të tjerë financiarë, kompani të sigurimit, fondet e pensioneve dhe ndihmësit financiarë). Më poshtë është struktura e korporatave financiare në BQK.

33. *Korporatat e tjera depozituese (KTD)* përbëhen nga bankat tregtare, korporatat e tjera që mbajnë depozita si dhe fondet e tregut të parasë. Në rastin e Kosovës, korporatat e tjera depozituese janë banka komerciale. Që nga qershori 2004, ka një ndryshim metodik në lidhje me përpilimin dhe publikimin e statistikave të këtyre korporatave në kontekstin e sektorëve, instrumenteve dhe afateve kohore. Kjo konsiston në fillimin e zbatimit të projekteve statistikore: Raporti Statistikor Bankar dhe Raporti i Normave të Interesit. Për më tepër, këto projekte statistikore janë avancuar vazhdimisht në kontekstin e vëllimit të statistikave, sektorëve, instrumenteve dhe afateve kohore.

34. *Ndërmjetësimi e tjerë financiarë (NTF)* përfshijnë të gjitha korporatat rezidente të angazhuara në ndërmjetësim financiar përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimeve dhe fondeve të pensioneve. Në rastin e Kosovës, ndërmjetës të tjerë financiarë janë institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jashtë bankës. Këto institucione financiare janë të angazhuara kryesisht në huadhënie në sasi më të vogla krahasuar me ato të bankave, kryesisht në zonat rurale, ndërkohë që financimi kryesisht ofrohet nga donatorët. Që nga fillimi i publikimit të këtyre statistikave (qershor 2004) deri në dhjetor 2007, bilanciç janë përpiluar në bazë të llogarive vjetore të institucioneve mikrofinanciare të raportuara në BQK. Megjithatë, duke filluar nga viti 2008, institucionet mikrofinanciare i raportojnë BQK-së në bilanciç gjendjes së bilanciç të pasqyrës së të ardhurave dhe statistika të tjera relevante.

35. *Ndihmësit financiarë (NF)* janë institucione financiare që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me ndërmjetësimin financiar, të cilat mund të jenë shkëmbime, agjentë etj. Në rastin e Kosovës ky nënsektor përbëhet nga zyrat e këmbimit dhe agjencitë e transferimit të parave. Brenda asistentëve financiarë, të dhënat merren bazuar në një mostër që përfshin rreth 95% të këtyre institucioneve bazuar në kontekstin e pasurive të tyre.

36. *Kompanitë e sigurimeve (KS)* përbëhen nga subjekte ku funksioni kryesor i të cilave është të sigurojë jetë, aksident, sëmundje, zjarr, ose forma të tjera të mbulimit për njësitë individuale institucionale ose grupet e njëjësive, ose shërbime të risigurimit për korporatat e tjera të sigurimeve.

37. *Fondet e Pensioneve (FP)* përbëhet nga fonde të pensionit autonom të cilat janë themeluar për të siguruar përfitime për pension për grupe të veçanta të individëve. Këto fonde pensione kanë grupe të veçanta të mjeteve dhe detyrimeve të fondit të pensioneve, me detyrime specifike ndaj kontribuuesve të tyre. Në rastin e Kosovës, skema e fondit të pensioneve përbëhet nga tre shtyllat e mëposhtme:

a) Pensioni i detyrueshëm bazë, i cili në fakt përfaqëson sigurimet shoqërore, paguhet direkt nga Buxheti i Kosovës

Për të gjithë personat mbi 65 vjeç;

b) kontributet individuale të pensioneve përbëhen nga fondet e paguara nga punëdhënësi (5% e pagës së punonjësit) dhe të punësuarit (5% të pagës) dhe të menaxhuara nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës;

c) Kontributet shtesë pensionale, të paguara për punëtorët të cilët mund të alokohen nga punonjësi në të gjitha fondet e licencuara të pensioneve që veprojnë në Kosovë

Në rastin e Kosovës, pensioni bazë i detyrueshëm (pika "a") është pjesë e sektorit fiskal, ndërsa kontributet individuale të pensioneve (pika "b") dhe kontributet pensionale plotësuese (pika "c") janë pjesë e sektorit financiar. Në rastin e Kosovës, statistikat për fondet e pensioneve përpilohen dhe publikohen në baza tremujore, në përputhje me standardet statistikore ndërkombëtare.

38. *Korporatat jo financiare* përfshijnë njësitë institucionale - personat juridikë me aktivitet parësor të prodhimit të mallrave dhe / ose ofrimin e shërbimeve jo financiare të destinuar për treg.

Në varësi të faktit nëse ato kontrollohen nga qeveria, korporatat jo financiare bëjnë dallimin midis dy nënsektorëve:

- korporatat jo financiare publike (të kontrolluara nga qeveria) dhe
- korporata të tjera jo financiare (jo të kontrolluara nga qeveria).

39. *Korporatat jo financiare publike* përfshijnë të gjitha korporatat jo financiare të kontrolluara nga njësitë qeveritare. Kontrolli është përcaktuar si një mundësi për qeverinë që të krijojë politikën e përgjithshme të korporatës, duke mbajtur më shumë se 50% të aksioneve me të drejtë vote, të përcaktuara nga një rregullorë që i jep të drejtën qeverisë për të vendosur mbi politikën e korporatës ose për të caktojë menaxhmentin.

40. *Qeveria*

Sektori i qeverisë përfshin njësitë institucionale të themeluara për të zbatuar politikën e qeverisë duke përdorur instrumente të rregullimit ekonomik, transferimin / rishpërndarjen e të ardhurave nga tarifatat e detyrueshme ose që përfaqësojnë prodhuesit jomarket me produkte të destinuar për konsum individual dhe të përbashkët, kryesisht të financuara përmes pagesave të detyrueshme të bëra nga sektorë të tjerë. Sektori qeveritar përbëhet nga nënsektorët e mëposhtëm:

- Qeveria qendrore;
- Qeveria shtetërore,
- Qeveria lokale dhe
- Fondet e sigurimeve shoqërore.

41. *Qeveria qendrore* Njësitë e qeverisjes së përgjithshme ushtrojnë pushtet legjislativ, gjyqësor ose ekzekutiv mbi njësitë e tjera institucionale brenda një zone të caktuar. Në rastin e Kosovës, qeveria përbëhet nga qeveria qendrore dhe qeveritë lokale. Brenda qeverisë qendrore përfshihen Kuvendi i Kosovës, Ministrinë, Administrata Tatimore, etj., Ndërsa brenda pushtetit lokal përfshihen Komunitatet.

42. *Ekonomit Familjare*

Përfshin personat dhe grupet e personave në kuptim të konsumatorëve dhe individëve të vetëpunësuar që prodhojnë mallra të destinuar për treg. Përveç kësaj, ky sektor përfshin personat dhe grupet e personave që prodhojnë mallra dhe ofrojnë shërbime jo financiare vetëm për përdorimin e tyre. Ky sektor përfshin individë, individë të pavarur dhe individë të cilët, siç përcaktohet me Ligjin për Kompanitë Tregtare, nuk konsiderohen shitës.

43. *Institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve*

Sektori i institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve përfshin institucionet jofitimprurëse që përbëjnë subjekte juridike. Burimet kryesore të financimit të tyre janë kontributet vullnetare në para të gatshme dhe në natyrë (mallra).

Ky sektor përfshin njësitë institucionale që ofrojnë mallra dhe shërbime për familjet: sindikatat, shoqatat profesionale dhe joprofesionale, shoqatat e konsumatorëve, partitë politike, kishat dhe shoqatat fetare (duke përfshirë ato të financuara, por jo të kontrolluara nga qeveria). Klubeve sportive, organizatave vullnetare, humanitare dhe ndihmës (të financuara përmes transfereve vullnetare në para të gatshme ose në natyrë nga njësitë e tjera institucionale).

9. Instrumentet Financiare

Më poshtë është paraqitur struktura e bilanceve të institucioneve financiare, me shpjegimin e zërave kryesorë në anën e Aseteve dhe Detyrimeve.

44. Asetet

Në anën e asetëve, përbërësit kryesorë standard të bilancit monetar janë si në vijim:

45. *Ari monetar* përfaqëson arin e mbajtur nga banka qendrore si pjesë e rezervave valutore zyrtare. Ari që nuk janë pjesë e rezervave valutore zyrtare klasifikohen si aset jo financiarë. Ari monetar vlerësohet në bazë të çmimit të tregut të arit.
46. *Të drejtat speciale të tërheqjes* (DST) përfaqësojnë asetet e rezervës ndërkombëtare të krijuara nga FMN dhe të aplikuara në shtetet anëtare për të plotësuar rezervat ekzistuese zyrtare të huaja. Ato përfaqësojnë të drejta të pakushtëzuara për të marrë hua ose pasuri të tjera rezervë nga anëtarët e FMN. Që nga qershori i vitit 2009, Republika e Kosovës është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Vlera e DST-ve të alokuara është 59 milion DST që i jep të drejtën e 840 votave, ose 0.04 përqind të fuqisë votuese në FMN.

Paraja e gatshme përfshijnë kartëmonedha dhe monedha me vlerë nominale fikse, të lëshuara nga banka qendrore si monedhë ligjore në ekonominë e vendit. Monedhat ari ose ato që nuk janë në qarkullim aktiv klasifikohen si aktive jo financiare.

47. *Paraja e gatshme gjithashtu përfshijnë* valutat e huaja, të tilla si kartëmonedha dhe monedha të lëshuara nga jo-rezidentët, kryesisht bankat qendrore të vendeve të huaja.

Në rastin e Kosovës, BQK-ja nuk emeton para të gatshme, mirëpo që përdor valutën euro si valutë zyrtare dhe si mjet pagese.

Depozitat klasifikohen në dy përbërës kryesorë:

1. *Depozitat e transferueshme përfshijnë* depozitat që janë të shkëmbyeshme me kërkesë pa kufizime dhe depozita që mund të përdoren me kërkesën për pagesa me çeqe, urdhëresa bankare, faturë borxhi, llogari rrjedhëse etj.

2. *Depozitat tjera Grupi i dytë përbëhet nga* depozita të tjera që përfshijnë:

- *Depozitat pa afatë* - këto depozita lejojnë tërheqjen e parave të gatshme, por jo pagesat e drejtpërdrejta për palë e treta;

- *Depozitat me afat* - këto depozita nuk janë të disponueshme sipas kërkesës, pasi që ato janë të kushtëzuara pas datës së caktuar të tërheqjes ose me njoftim paraprak.

- *Depozitat me afat fikse* që ofrohen nga institucionet e depozitimit për klientët e tyre me një normë më të lartë interesi sesa një llogari e rregullt e kursimeve. Këto janë me maturime që fillojnë nga një muaj deri në disa vjet. Kur caktohet një depozitë me afat të caktuar, fondi mund të tërhiqet vetëm pasi të mbarojë afati ose duke dhënë një njoftim për një ditë të paracaktuar, dhe

- *Depozita të tjera.*

48. *Letrat me vlerë përveç aksioneve* janë aktive financiare që janë të negociueshme dhe tregtohen në tregjet sekondare. Ata nuk i japin të drejtën pronësisë mbajtësit të njësisë institucionale që i ka lëshuar ato, por i japin të drejtën e pakushtëzuar për të marrë të ardhura fikse ose të ndryshueshme në formën e pagesave të kuponit (interesit) ose një sasi të caktuar fikse që paguhet në një datë të caktuar.

Ky instrument përfshin: bonot, obligacionet, faturat e depozitave, faturat komerciale, faturat e ngarkuara dhe instrumentet e ngjashme. Letrat me vlerë mund të jenë afatshkurtra dhe afatgjata.

49. *Letrat me vlerë afatshkurtrë*, të ndryshme nga aksionet, kanë një maturim fillestar prej një viti dhe zakonisht lëshohen me zbritje. Ato përfshijnë instrumentet në vijim: Bonot dhe letrat e tjera afatshkurtra të lëshuara nga Qeveria, letra të negociueshme afatshkurtra të lëshuara nga korporatat financiare dhe jo financiare.

50. *Letrat me vlerë afatgjatë*, përveç aksioneve, kanë maturim mbi një vit dhe zakonisht lëshohen me kupona. Ato përfshijnë instrumentet në vijim: obligacionet që i paguhen mbajtësit, obligacionet e varura, obligacionet me maturim alternative, obligacionet e papaguara ose të fiksuara, letrat me normat e ndryshueshme dhe letrat me vlerë të tjera afatgjata, euro bonove dhe të tjera.

51. *Kreditë* janë instrumente financiare që krijohen kur kreditori i jep fonde hua të drejtpërdrejt një debitori dhe janë dokumentuar me dokumente që nuk janë të negociueshme.

Kjo kategori përfshin të gjitha kreditë e dhëna për sektorë të ndryshëm nga korporatat financiare.

Kategoria e kredive përfshin:

- _ kredi për blerje patundshmerie,
- _ kredi konsumatorë,
- _ hua për financimin e kredive tregtare,
- _ kredi rrotulluese,
- _ kredi që shërbejnë si garanci për disa detyrime,
- _ marrëveshjet e riblerjes së letrave me vlerë,
- _ qira financiare dhe lloje të tjera kredish.

Sipas maturitetit, kreditë mund të ndahen në afat të shkurtër (me maturim deri në një vit) dhe afatgjatë (me maturim mbi një vit).

52. *Aksionet dhe kapital tjetër*

Kjo kategori përfshin instrumente financiare që i japin mbajtësit të drejtën e pronësisë së shoqërisë që ka nxjerrë këto instrumente. Mbajtësi i këtyre letrave me vlerë ka të drejtë në pjesën e të ardhurave dhe në një pjesë të mjeteve neto në rast të likuidimit. Ky instrument përfshin dy nën-kategoritë e mëposhtme:

a) aksionet dhe kapitalet e tjera, përveç njësive të fondeve të investimit:

- 1) aksione të listuara në bursë;
- 2) aksione që nuk janë të listuara në bursë;
- 3) kapital tjetër

b) njësitë e fondeve të investimeve

53. *Rezerva teknike e sigurimeve*

